



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR**

**VENDIM**

**Nr.71, datë 27.08.2026**

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR  
SHTETASIN BASHKIM HASANLLARI”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.08.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “ Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendim me nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin Bashkim Hasanllari.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shtetasin Bashkim Hasanllari .
2. Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602,zëri shpenzime operative administrate, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Elsa PETRITAJ**

